



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

“Kujtesa Net” Sh.p.k.
Pronar: “Kujtesa Net” Sh.p.k.
OSHP Star Movies
Rr. Pashko Vasa Nr. 18
Prishtinë

VENDIMI: LIC/KPM-2013/23
Ref: 1306/744/LIC/ni

VENDIM

në lidhje me kërkesën e Ofruesit të Shërbimeve Programore Star Movies për ndryshimin e emrit në K-Shqip

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Ofruesi i Shërbimeve Programore (OSHP) Star Movies, me seli në Prishtinë, është pajisur me licencë të KPM-së më datën 5 dhjetor 2008, për të vepruar si OSHP.
3. Komisioni i Pavarur për Media, më datën 21 maj 2012, ka pranuar kërkesën nga pronari i Star Movies për ndryshimin e emrit nga Star Movies në K-Shqip.

Arsyetim

4. Kërkesa për ndryshimin e emrit të OSHP Star Movies në K-Shqip është bërë për shkak se, pronari mendon se emri i propozuar është më i përshtatshëm për rritjen e shikueshmërisë së Ofruesit të Shërbimeve Programore.
5. Kërkesa për ndryshim të emrit të Star Movies në K-Shqip, nuk paraqet asnjë ndryshim tjetër në Pakon e Licencës së KPM-së për këtë OSHP.


6. Emri i propozuar K-Shqip, për t'u identifikuar në të ardhmen si OSHP në Republikën e Kosovës, nuk është i ngjashëm me asnjë nga emrat e subjekteve transmetuese të licencuara nga KPM, që operojnë në Republikën e Kosovës.

Vendim

7. Komisioni, konkludon që ndryshimi i emrit të OSHP Star Movies në K-Shqip nuk paraqet ndryshime në pronësi apo në skemën e programore.
8. Komisioni, merr vendim që OSHP Star Movies t'i lejohet ndryshimi i emrit në K-Shqip.

Lëshimi i Vendimit

9. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur për Media dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit.



Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



6 gushtor 2013
datë